



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional "Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design"
Kolegji Universitar "Qiriazi"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Dr. Elior Vila

Prof. Thoma Korini

Shkurt 2022

Për Programin e studimit me Karakter Profesional "Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "QIRJAZI"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë profesionale "Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr.412, Datë 13.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/5 PAK
18	Numri i studentëve:	33 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Qiriazi" (KUQ) është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.274, datët.10.05.2006 (Emërtimi Shkolla e Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi") dhe i riorganizuar me Urdhërin Nr.92, datë 1.3.2017 (Kolegji Universitar "Qiriazi"). KUQ i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 24, datë 11.05.2018, me kohëzgjatje 2 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 10.05.2020 dhe aktualisht ka aplikuar dhe ndodhet në fazën e riakreditimit institucional.

Kolegji Universitar "Qiriazi", me seli në Godinën "Qiriazi" – Rruga "Taulantët", Lagja Kodër-Kamëz, Tiranë, përbëhet nga katër njësi kryesore: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit dhe Kolegji Profesional i Lartë. Statuti i KUQ, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", është miratuar me Vendim Senati Akademik të KUQ nr. 19, datë 11.01.2017 dhe me Urdhër Nr.92, datë 1.03.2017 të MASR. Ndryshimet në Statut janë miratuar me Vendimin Nr.84, datë 18.11.2020 të Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të KUQ dhe me Urdhër nr. 362, datë 23.12.2020 të MASR. Hapja e njësisë kryesore "Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit" është realizuar me Urdhër Nr.214, datë 14.7.2021 të MAS.

Hapja e programit të studimit me karakter profesional "**Teknologji informacioni**", në profilet "*Teknologji informacioni dhe komunikim*", "*Elektronikë*" dhe "*Web Design*" është realizuar nëpërmjet Urdhërit të MASR, Nr.412, Datë 13.07.2018. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, njësi përbërëse e Kolegjit Profesional të Lartë.

Programi i studimit me karakter profesional "**Teknologji informacioni**", në profilet "*Teknologji informacioni dhe komunikim*", "*Elektronikë*" dhe "*Web Design*" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin European të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e teknikëve të lartë të aftë në përdorimin dhe administrimin e rrjeteve, në përpunimin e zërit, përpunimin dhe aplikimin e të dhënave dhe të figurës, në aplikimet dhe shërbimet komunikuese multimediale, transaksionet bankare, komunikim biznesi etj. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KUQ.

KUQ ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit me karakter profesional "**Teknologji informacioni**", në profilet "*Teknologji informacioni dhe komunikim*", "*Elektronikë*" dhe "*Web Design*" më datë 27.02.2020 dhe riaplikuar më datë 29.12.2020, ndërsa dosja e dokumentacionit të akreditimit është transmetuar në 30.09.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin e parë të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në gusht 2021. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KUQ për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KUQ, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr. 370, datë 26.4.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë", VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Arjana Alija. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Drejtorin e Kolegjit të Lartë Profesional dhe Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivit, përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Kolegji Universitar "Qiriazi" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.02.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 75/1 Prot, datë 10.02.2022. Kolegji Universitar "Qiriazi" përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 27 Prot, datë 15.02.2022, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design"

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PRORAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " është hartuar, përditësuar, plotësuar dhe përshatur në përputhje me nevojat që ka tregu i punës dhe ekonomia shqiptare si dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar "Qiriazi" [Ev. <i>Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit; Plani Strategjik i Zhvillimit të KPL; Mendimi i Drejtorit të KPL</i>].
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në Statutin e KUQ përcaktohet, ndërmjet të tjerash, si mision i tij, përgatitja e specialistëve dhe teknikëve të lartë me dije bashkëkohore si dhe nxjerrja në tregun e punës të specialistëve të lartë e profesionistë me aftësi, njohuri e kompetenca në fushën e tyre të studimit [Ev. <i>Statuti i KUQ, Neni 3</i>].
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	KUQ mbështet ofrimimin e programit të studimit me karakter profesional në VKM Nr. 370, datë 26.4.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë" dhe Urdhërin e MASR, Nr.412, Datë 13.07.2018 për Hapjen në KUQ të programit të studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> ", në profilet " <i>Teknologji informacioni dhe komunikim</i> ", " <i>Elektronikë</i> " dhe " <i>Web Design</i> " [Ev. <i>VKM Nr.370, Urdhër i MASR Nr.412</i>]. Ofrimi i këtij programi studimi realizohet me mbështetjen e njësisë bazë, Departamentit i Teknologjisë së Informacionit, duke qënë në një linjë me fushën akademike të tij.
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " mbështetet në kërkesat aktuale për zhvillimin e arsimit profesional dhe specifikuat në kërkesat në fushën e teknologjisë së informacionit. Nga shqyrtimi i DVV, GVJ u njoh me studimin e tregut të punës paraqitur në fazën e propozimit për hapjen e programit të studimit dhe i gjen me vend argumentimet dhe konkluzionet e paraqitur në këto studime [Ev. <i>Studim për tregun e punës përpara hapjes së programit</i>].
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Studimi periodik i tregut të punës i realizuar pas hapjes së programit të studimit mbështet nevojën e formimit të specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit duke planifikuar ndjekjen e ecurisë së studentëve në tregun e punës. Gjithashtu në këtë studim janë evidentuar edhe subjekte të cilët kanë nevojë për specialistë të këtij profili. Mbështetja e zhvillimit të këtij programi studimi bazohet edhe

	në praninë në zonë (Kamëz) edhe të shkollës së mesme Profesionale Kombëtare që ka degë të teknologjisë Informacionit. [Ev. Studim periodik për tregun e punës].			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	GVV konstatoi se studimi paraprak dhe periodik i tregut të punës i realizuar nga KUQ bëjnë një analizë të thelluar duke trajtuar ofertën arsimore në fushën e teknologjisë së informacionit bazuar në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020 ku konstatohet se ka pak të diplomuar në fushat mjaft të kërkuara ku, ndër të tjera, bën pjesë dhe teknologjia e informacionit me kërkesa për specialistë të TI, analistë dhe programues [Ev. Studim periodik për tregun e punës].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fudit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " mbulohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI). Për të mundur formimin e studentëve me njohuritë e kërkuara për këtë program, DTI bashkëpunon edhe me departamente të tjerë të KPL si dhe më gjerë në nivel institucioni duke përcaktuar qartë si nivelin e angazhimit ashtu edhe detyrimet reciproke [Ev. Analizë vjetore e DTI]. Raporti vjetor mbi veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të DTI i shërben përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies duke përcaktuar edhe detyra për të ardhmen. Për vitin akademik 2020-2021 në programin e studimit janë angazhuar në total 11 personel akademik, nga të cilët 6 PAE dhe 5 PAK. Personeli akademik efektiv mbulon rreth 62-65% të ngarkesës mësimore (viti akademik 2019-2020 dhe 2020-2021) [Ev. shtesë: Ngarkesa mesimore 2019-2020; Ngarkesa mesimore 2020-2021].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se KUQ ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit [Ev. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit TI dhe praktikën profesionale]. Këta elementë konfirmohen edhe nga takimet në institucion.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga	GVJ u njoh me raportin e hartuar nga DTI " <i>Mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit profesional te ciklit 2-vjeçar "Teknologji Informacioni"</i> ". Në këtë raport paraqiten

marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	përfitimet nga aktmarrëveshjet e bashkëpunimit si dhe janë paraqitur edhe detyra për të ardhmen në drejtim të një analize periodike të përfitimeve nga bashkëpunimi e në mënyrë të veçantë zgjerimin e bashkëpunimit në shërbim të praktikave të studentëve dhe punësimit të ardhshëm të tyre. [Ev. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit TI]			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Marrëveshjet me komunitetin e biznesit dhe shoqëritë private, i kanë shërbyer kryesisht realizimit të praktikave profesionale me studentët, krijimit të mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve si dhe punësimit të tyre mbas diplomimit [Ev. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit TI dhe praktikën profesionale; Takimet në institucion].			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Nga takimi me studentët GVJ u informua për angazhimin e DTI për garantimin e një shkëmbimi të vazhdueshëm me botën e biznesit me qëllim punësimin e studentëve. Rreth 70-80% e të diplomuarve janë tashmë të punësuar [Ev. Takimi me studentët]. Gjithashtu rezultate pozitive ka patur edhe në punësimin e studentëve me kohë të pjesshme. [Ev. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit TI].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Referuar planit mësimor, GVJ konstatoi se programi i studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni " është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 2 vite akademike me nga 2 semestra secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 120 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite.
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni " i korrespondon Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat në: <ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimin e teknologjisë informatike dhe të ndihmuarit e të tjerëve gjatë shfrytëzimit të të njëjtës teknologji; - Në përpunimin, krijimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve aplikative dhe në WEB për probleme të ndryshme. - Në planifikimin dhe realizimin e bazave të të dhënave; - Në planifikimin dhe realizimin e rrjeteve kompjuterike.

	<p>[Ev. Rregullore e programit të studimit TI]</p> <p>GVJ është i mendimit se njohuritë e përftuara në këtë program studimi profesional krijojnë një bazë dhe shprehi të mjaftueshme praktike në fushën e teknologjisë së informacionit për të mundësuar punësimin në një shumëllojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh të lidhura me këtë fushë.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Specialistët e diplomuar në programin e studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni" fitojnë dije, aftësi dhe kompetenca të cilat u mundësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të shfrytëzojnë sistemet operative të teknologjisë së informacionit në përditshmëri dhe më gjerë; - Të zbatojnë në mënyrë efektive gjuhët programuese dhe algoritmet e studiuara; - Të zgjidhin probleme të ndryshme; - Të organizojnë baza të dhënash, t'i projektojnë, zbatojnë dhe më tej të mirëmbajnë dhe rregullojnë performancat e tyre; - Të projektojnë dhe zbatojnë rrjetat kompjuterike; - Të shfrytëzojnë në mënyrë efektive sistemet dhe teknologjinë informatike; - Të zbatojnë dhe administrojnë faqe Web statike dhe dinamike, si dhe të jenë në gjendje të kryejnë shërbime të ndryshme në Web; - Të organizojnë dhe të ndihmojnë zgjidhjet teknike duke i përshtatur ato me zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe tekniko –shkencore.
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>[Ev. Rregullore e programit të studimit TI]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>KUQ i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 24, datë 11.05.2018, me kohëzgjatje 2 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 10.05.2020 dhe aktualisht ka aplikuar dhe ndodhet në fazën e riakreditimit institucional.</p> <p>Njësitë kryesore të KUQ dhe në veçanti KPL përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë [Ev. Statuti i KUQ]. Referuar personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në të, GVJ konsatoi se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DTI në stadin aktual ka pesë anëtarë të punësuar me kohë të plotë duke përmbushur detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike [Ev. Lista e stafit akademik]. Për vitin akademik 2020-2021 në programin e studimit janë angazhuar në total 11 personel akademik (6 PAE dhe 5 PAK), nga të cilët 1 PAE dhe 1 PAK personel akademik i fakulteteve të tjerë të KUQ [Ev. shitesë: Ngarkesa mesimore 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve. Ky program i formon studentët në tre drejtime kryesore: "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design". Ky formim mundësohet nëpërmjet Lëndëve Bazë, Lëndëve karakterizuese, Lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese, Lëndëve Plotësuese, Praktikës profesionale dhe Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar/Punimit të Diplomës që ofron programi për të tre drejtimet. Objektivat e programit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - T'u mundësojë studentëve që të fitojnë njohuri teorike dhe praktike

	<p>për teknologjinë e informacionit si edhe t'i aftësoj për zbatimin e tyre në jetën reale.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aftësimin e studentëve për fushat kryesore të TIK siç mund të jenë bazat e programimit, teknologjitë kryesore të internetit, rrjetat kompjuterike, bazat e elektronikës. - Studentët e diplomuar të jenë të aftë të zbatojnë teknologjitë e reja të internetit dhe rrjeteve në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme. - Aftësimin e studentëve për pjesëmarrje në zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të ndryshme telematike. - Aftësimin e studentëve për pjesëmarrje në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të ndryshme aplikative në ndihmë të zgjidhjes së problemeve. - Aftësimin e studentëve për të punuar në projekte individuale dhe në grup, që sipas natyrës mund të jenë: projekte shkencore-hulumtuese, projekte zhvillimore ose punë praktike. <p>[Ev. Dosja e programit të studimit TI; Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TI; Plani mesimor i programit të studimit TI; Syllabuset për programin TI]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Programi i studimit profesional 2-vjeçar "Teknologji Informacioni", është hartuar me objektiva të qarta formuese dhe objektiva mbi tregun e punës, si dhe jep informacione mbi rezultatet e të nxënit, organizimin dhe strukturën e tij. Informacione të detajuara jepen në syllabuset e lëndëve që përbëjnë programin e studimit. [Ev. Rregullore e programit të studimit të ciklit 2-vjeçar TI; Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit 2-vjeçar TI; Syllabuset për programin TI]

<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit profesional 2-vjecar "Teknologji Informacioni", është organizuar në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me 120 kredite në total, të ndara në 2 vite akademike apo në 4 semestra dhe është në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi. Programi i studimit po ashtu është rishikuar në vitin akademik 2020-2021 për të qenë në përputhje me VKM Nr. 879 dt. 18.12.2019. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, detajet mbi ngarkesën mësimore të programit të studimit profesional 2-vjecar "Teknologji Informacioni", përshkruhen përkatësisht në planin mësimor dhe programin mësimor. Në këtë të fundit jepet një ndarje e qartë e ngarkesës në auditor, punës së pavarur, krediteve dhe formës së vlerësimit. GVJ është i mendimit që në planin mësimor, përcaktimi i ndarjes së ngarkesës midis seminareve dhe laboratorëve do ta bënte më të qartë ngarkesën e punëve të laboratorit të cilat janë të rëndësishme në aspektin e formimit profesional. P.sh. lënda "Bazat e Elektronikës" në planin mësimor paraqitet me ngarkese 30 leksione dhe 30 seminare në auditor, ndërkohë që në programin mësimor paraqitet me ngarkesë në auditor 30 leksione dhe 30 laboratorë. Po ashtu në lëndët Anglisht 1 dhe Gjermanisht 1 është vënë re një mospërputhje e ngarkesës ku pasqyrohen 15 orë Leksione dhe 15 orë Seminare ndërkohë që "Gjithësej" pasqyrohen 45 orë. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Secila lëndë e programit të studimit, ka të përcaktuar në syllabus të gjithë informacionin e detajuar për të gjitha komponentët, aktivitete të ndryshme dhe formën e kontrollit të dijeve. Syllabuset janë ndërtuar në përputhje me kriteret ligjore dhe me ngarkesën e përcaktuar në planin mësimor. Ndërkohë që orët e laboratorit janë përcaktuar të detajuara vetëm në programin mësimor. [Ev.Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Syllabuset per programin TI]</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Programi i studimit ka karakter profesional dhe si i tillë është mjaftueshëm fleksibël për të mundësuar një formim cilësor të studentëve si edhe për të patur një qasje me tregun e punës. Struktura dhe organizimi i tij është bërë duke konsultuar edhe programe të ngjashme të huaja të përshtatura për kushtet dhe mundësitë në tregun shqiptar. [Ev. Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Syllabuset per programin TI; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtorin e kolegjit dhe pergjegjesin e dept. te TI si edhe takimi me studentet]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Nga programi mësimor vihet re që në shumicën e lëndëve me karakter teknik, janë përcaktuar në ngarkesë punët e laboratorit duke nxitur mësimin praktik në përputhje edhe me misionin e programit profesional. Gërshetimi me praktikat profesionale në kompani të ndryshme rrit aftësitë profesionale të studentëve. [Ev. Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me pergjegjesin e DTI dhe studentet]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Emërtimi i programit, organizimi dhe struktura, shpërndarja e ngarkesës në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, me konkretisht VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018 dhe VKM Nr. 879 dt. 18.12.2019. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Kreditet sipas veprimtarive formuese]
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përshtatet me kërkesat e një programi profesional duke pasur parasysh raportin midis lëndëve të pjesës teorike dhe asaj praktike. Shumica e lëndëve është me karakter teknik profesional, në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit, si dhe me pritshmërinë e të nxënit dhe të punësimit të studentëve që kryejnë këtë program studimi. [Ev. Plani strategjik i zhvillimit te programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me studentet]
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Plani mësimor i shoqëruar me syllabuset japin informacion të detajuar mbi lëndët, emërtimet, ngarkesën në orë, kreditet dhe format e vlerësimit në përputhje me kriteret e përmbajtjes së programit. Syllabuset i nënshtrohen diskutimeve të vazhdueshme për të rifikuar temat në varësi të zhvillimit të fushës së TI. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Syllabuset per programin TI; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik te programit TI]
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.	Duke ju referuar programit mësimor, GVJ konstatoi se të gjitha lëndët, si ato me karakter teknik dhe ato jo teknik, në syllabuset e tyre ruajnë një balancë ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik (50:50) sipas përcaktimeve ligjore. Edhe tek ato lëndë që nuk parashikojnë laboratorë por vetëm seminare, stafi akademik bën një gërshetim të pjesës teorike me atë praktike duke përdorur laboratorët përkatës. Përfshirja e praktikës profesionale rrit përqindjen në favor të formimit praktik të studentit duke e aftësuar atë akoma më shumë për tregun e punës. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Syllabuset per programin TI; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin

	akademik te programit TI]			
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Raporti i ekuilibruar ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik, mundëson arritjen e objektivave formuese të studentit. Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formues, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Kreditet sipas veprimtarive formuese]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Përbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit përmban të dhëna në detaje mbi lëndët, ndarjen e tyre në module si edhe aktiviteteve të tjera mësimore në funksion të plotësimi të objektivave dhe të një formimi sa më cilësor të studentëve. Po ashtu edhe stafi akademik zbaton me rigorozitet kërkesat sipas strukturës së planit të studimit të parashikuara këto në syllabuset e lëndëve përkatëse. [Ev. Plani mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Syllabuset per programin TI; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik te programit TI]
Kriteri 2. Përbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehitë e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Lëndët e përcaktuara në programin mësimor, janë lëndë të cilat jo vetëm plotësojnë formimin teorik dhe praktik të studentit, por janë të orientuara nga kërkesat e tregut, duke përbushur dhe kërkesat e profesioneve të lidhura me to, si psh. teknik IT, teknik sistemesh elektronike, zhvillues dhe mirëmbajtës i sistemeve web etj. Praktika profesionale në kompanite e biznesit po ashtu rrit aftësinë e komunikimit dhe përshtatjen me tregun e punës. [Ev. Plani strategjik i zhvillimit te programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me studentet]
Kriteri 3. Përbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e	Syllabuset e lëndëve, kanë të përcaktuara metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe parashikimin për zhvillimin e aftësive të transferueshme. Ndërveprimi me stafin akademik dhe mentorët e praktikave profesionale, ka bërë që studentët jo vetëm të marrin informacionin e nevojshëm dhe njohuritë bashkëkohore, por edhe të

mësimdhënies dhe vlerësimit.	aftësohen në zotërimin e kompetencave profesionale të nevojshme në tregun e punës. [Ev. <i>Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit 2-vjecar TI; Programi mesimor i programit të studimit të ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>]			
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Përfshirja e lëndëve dhe moduleve në planin mesimor është bërë me qëllimin e jo vetëm të një formimi teknik por dhe të një formimi të pasur ndërdisiplinor, si edhe të rritjes së aftësive komunikuese si një element shumë i rëndësishëm në tregun e punës. Në përputhje edhe të qëllimit kryesor të programit të studimit, i kushtohet vëmendje e veçantë aftësive të studentit në zgjidhjen e problemeve apo implementimin e zgjidhjeve në praktikë. Punët e laboratorit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në aftësimin praktik ku studentët mund të përfshihen në ndërtimin e aplikacioneve apo qarqeve elektronike konkrete. [Ev. <i>Programi mesimor i programit të studimit të ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>]			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Marrëveshjet e bashkëpunimit të institucionit me palët e treta, në formën e praktikave profesionale, internship-e dhe tutorazhit, garantojnë formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit, KUQ ka nxitur bashkëpunimin me institucione të tjera duke lidhur marrëveshje si me IAL-të ashtu edhe me kompanitë e biznesit të cilat shihen si mundësi reale për punësimin e të diplomuarve në të ardhmen. Marrëveshjet kanë qenë të shtrira edhe në fushën e bashkëpunimit akademik apo të nxitjes së veprimtarisë kërkimore shkencore nëpërmjet organizimit të konferencave apo workshopeve. [Ev. <i>Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të programit të studimit të ciklit 2-vjecar TI; Tabele përmbledhese me insitucionet bashkëpunuese për programin e studimit TI dhe praktiken profesionale; Vizita e GVJ dhe takimi me studentet</i>]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>KUQ, nëpërmjet rregulloreve të brendshme ka përcaktuar mënyrat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së procesit mësimor dhe aftësive të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit TI. Njësia e krijuar për këtë qëllim Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në përbërje të të cilës ka edhe studentë, monitoron aktivitetet e ndryshme dhe raporton në organet drejtuese si edhe në senatin akademik dhe bordin e administrimit. Në bazë të rezultateve bëhen edhe analizat përkatëse mbi problemet e mundshme apo masat që duhen marrë për zgjidhjen e tyre. Procesi është transparent dhe rezultatet ju bëhen të ditura njëjësive kryesore dhe bazë.</p> <p>[Ev. Rregullore e KUQ; Rregullore e NJSBC; Vizita e GVJ dhe takimi me perfaqesues te NJSBC]</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Përveç formave standarte të mësimdhënies dhe mësimnxënies, stafi akademik i angazhuar në programin TI përdor edhe forma dhe metoda alternative bashkëkohore. Aty përfshihen si p.sh. prezantime me videoprojektor, paraqitje e videove të ndryshme ilustruese në platformat web, diskutime me profesionistë të ftuar në orë të hapura, softuerë të posaçëm për punët laboratorike me simulime, workshope etj. Këto aktivitete realizohen në përputhje me rregulloret dhe misionin e institucionit për të realizuar sa më mirë programin e studimit.</p> <p>[Ev. Programi mesimor i programit të studimit te ciklit 2-vjecar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtorin e kolegjit, pergjegjesin e DTI, stafin akademik dhe studentet]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik përzgjidhet në bazë të kriterëve dhe procedurave përkatëse në përputhje me nevojat e KUQ. Një pjesë e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, në programin profesional 2-vjeçar “Teknologji informacioni”, kanë përvojë të gjatë në IAL-të dhe një pjesë kanë kryer cikle të ndryshme studimi jashtë vendit duke qenë të njohur me përdorimin e metodave interaktive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilat janë të përfshira në syllabuset e lëndëve. KUQ ka marrë masa edhe për t’ju përgjigjur nevojave të komunikimit dhe procesit mësimor në kushtet e pandemisë.</p> <p>[Ev. Procedurat e emerimit te stafit akademik ne KPL; Udhëzim per kualifikimin e stafit akademik ne KUQ; CV e stafit akademik]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme, duke ju referuar CV-ve të vëna në dispozicion, rezultojnë të ketë një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie duke kombinuar metoda të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me temat e përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Një rëndësi e veçanta i është kushtuar edhe</p>

tematikave dhe profilit.	rifresikimit të vazhdueshëm të materialit mësimor si edhe përshtatja e metodave të mësimdhënies në përputhje me zhvillimin e teknologjisë. [Ev. CV e stafit akademik; Vizita e GVJ dhe takimi me përgjegjesin e DTI dhe stafin akademik të programit TI]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	KUQ përmes aktiviteteve të ndryshme si p.sh. trajnime, prezantime nga ekspertë, konferenca etj., mbështet stafin për risitë më të reja, dhe përmirësimin e mëtejshëm në fushën e mësimdhënies. Shkëmbimi i eksperiencave dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me IAL-të e tjera, ka çuar në kualifikimin e vazhdueshëm dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies. [Ev. CV e stafit akademik; Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit; Vizita e GVJ dhe takimi me përgjegjesin e DTI dhe stafin akademik të programit TI]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Për të mbështetur procesin mësimor teorik dhe praktik, KUQ ka një numër sallash mësimore ku zhvillohen leksionet dhe seminarët. Po ashtu institucioni ka ngritur dy laboratorë për Teknologjinë e Informacionit dhe Elektronikën ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë punët e laboratorit. Infrastruktura në dispozicion plotëson kushtet e hapësirave të mjaftueshme për studentët dhe për aktivitetet e ndryshme shkencore dhe promovuese si salla konferencash etj. [Ev. Infrastruktura mesimore e KUQ; Raport vlerësimi i ambienteve mesimore: Vizita e GVJ në ambientet e KUQ (auditoret, laboratorët, sallat mesimore, sallat e konferencave)]
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët kanë akses dhe mund të shfrytëzojnë literaturën mësimore në formë elektronike si atë në librarinë dixhitale, e cila është duke u plotësuar në vazhdim. Në funksion të procesit mësimor, është në dispozicion edhe laboratori i TI i pajisur me software dhe hardware bashkëkohore ku studentët mund të zhvillojnë punët praktike apo punët e laboratorit sipas planit mësimor. Laboratori mund të shfrytëzohet

	<p>në kohën e lirë për të patur akses në materialet mësimore në internet. Sallat mësimore janë pajisur me projektorë për prezantimin e materialeve mësimore në formë elektronike. Po ashtu edhe stafi akademik është pajisur me mjettet e nevojshme IT në funksion të procesit mësimor duke marrë parasysh edhe kushtet e pandemisë dhe komunikimin në platformat online.</p> <p>[Ev. <i>Infrastruktura mesimore e KUQ; Vizita e GVJ ne ambjentet e KUQ (auditoret, labororet, sallat mesimore, sallat e konferencave)</i>]</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ajo ndihmëse përbëhet nga libra apo materiale të perkthyer dhe të pershtatura nga literatura e huaj bashkëkohore të cilët gjenden në bibliotekën e institucionit. Kjo literaturë ju vhihet në dispozicion studentëve si në forme të shtypur ashtu edhe në atë elektronike nëpërmjet komunikimit elektronik në platformat online të krijuara për këtë qëllim. Stafi akademik kujdeset për përshtatjen e literatures në përputhje me misionin e programit profesional TI.</p> <p>[Ev. <i>Lista e teksteve ne biblioteke ne funksion te programit TI; Vizita e GVJ dhe takimi me pergjegjesin e DTI dhe stafin akademik te programit TI</i>]</p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion ambiente biblioteka të pajisur me kompjutera ku studentët mund të aksesojnë literaturën në dispozicion e cila është ruajtur në mënyrë lokale dhe në distancë. Ky ambient mund të përdoret po ashtu edhe nga stafi akademik. Materialet janë në formë elektronike (duke përfshirë edhe CD, DVD) të sygjera nga stafi akademik i cili mund të shfrytëzojë edhe platforma jashtë institucionit për të shpërndarë materialet mësimore tek studentët.</p> <p>[Ev. <i>Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies; Vizita e GVJ ne ambjentet e KUQ (auditoret, labororet, sallat mesimore, biblioteka, sallat e konferencave)</i>]</p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Labororet e TI dhe Elektronikës i vendosen në dispozicion studentëve edhe stafit akademik për të realizuar detyrat sipas përcaktimeve dhe detyrimeve të planit mësimor. Labororet qëndrojnë të hapur ku çdo hapësirë kohore mund të shfrytëzohet nga studentët për të aksesuar burimet në internet, për zhvillimin e detyrave të kursit apo punëve laboratorike.</p> <p>[Ev. <i>Infrastruktura mesimore e KUQ; Vizita e GVJ ne ambjentet e KUQ (auditoret, labororet, sallat mesimore, biblioteka, sallat e konferencave)</i>]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të procesit të mësimdhënies, sidomos në kushtet e pandemisë, institucioni ka vënë në dispozicion platformat online Zoom, Google Classroom, Google Meeting për komunikimin me studentët dhe shpërndarjen e materialeve mësimore në formë elektronike. Po ashtu stafi akademik inkurajon studentët që të përdorin këto platforma si një mënyrë e shpejtë komunikimi dhe</p>

	efikase në krijimin e hapësirave të diskutimit midis studentëve. [Ev. Infrastruktura mesimore e KUQ; Vizita e GVJ ne ambjentet e KUQ (auditorët, laboratorët, sallat mesimore, biblioteka, sallat e konferencave)]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUQ ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilesise (NJSBC) e cila funksionon me qëllimin e monitorimit dhe koordinimit të aktiviteteve të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo njësi bashkërendon punën me njësite e tjera kryesore dhe në rastin konkret me DTI si njësi bazë, për të përpiluar raporte vlerësimi për stafin akademik dhe pyetësorë për studentët si burime informacioni. Këto raporte ndërmjetëse shërbejnë për të hartuar një raport përfundimtar i cili i dorëzohet rektoratit duke garantuar po ashtu edhe elementë të konfidencialitetit. Në bazë të raportit përfundimtar, merren edhe vendimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standarteve. Nga takimi i GVJ me përfaqësues të NJSBC, u vërejt se ajo është e angazhuar po ashtu edhe në përfshirjen e studentëve në intervista apo workshop-e. [Ev. Rregullore e KUQ; Rregullore e NJSBC; Vizita e GVJ dhe takimi me përfaqësues të NJSBC]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësite që monitorojnë procesin e mësimdhënies në programin profesional 2 vjeçar “Teknologji Informacioni” janë përkatësisht Kolegji Profesional i Lartë dhe Departamenti Teknologji Informacioni. Të dyja këto njësi bashkëpunojnë edhe me njësitë e tjera si NJSBC, në funksion të një monitorimi cilësor dhe garantimit të zbatimit me korrektësi të planeve mesimore, kurrikulave, strukturës akademike etj. Drejtuesit e KPL dhe DTI janë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës mesimore dhe kërkimore duke përpiluar edhe analizën vjetore si edhe duke përcaktuar masat që duhet të merren për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Njësitë përgjegjëse organizojnë po ashtu periodikisht edhe veprimtari specifike në mënyrë që të nxitet stafi akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë

	<p>së programit në tërësi. <i>[Ev. Rregullore e KPL; Rregullore e DTI; Rregullore e NJSBC; Analiza vjetore e DTI; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtuesin e DTI dhe stafin akademik]</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga stafi me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjeshme me kualifikime që i përgjigjen kërkesave të cilësisë së programit. Tendencia e personelit akademik është në implementimin e metodave bashkëkohore duke shfrytëzuar edhe literaturën që i përshatet këtij programi profesional. Stafi akademik është përgjegjës për të garantuar materialet e nevojshme mësimore në gjuhën shqipe duke përdorur si literaturë parësore atë në gjuhën angleze. Përdorimi i software-ve në zhvillimin e punëve të laboratorit ndikon po ashtu në rritjen e cilësisë. Puna kërkimore e personelit akademik nxitet nga kërkesa për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe seminare duke qenë në këtë mënyrë në kontakt të vazhdueshëm me të rejtat në fushën e IT. <i>[Ev. CV e stafit akademik; Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit; Vizita e GVJ dhe takimi me përgjegjës të DTI dhe stafin akademik të programit TI]</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Duke qenë se fusha e TI është mjaft dinamike, institucioni mbështet dhe inkurajon zhvillimin e metodave krijuese nga ana e stafit në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. KUQ ka marrëveshje me institucione të tjera për shkëmbimin e stafit akademik duke synuar një staf cilësor i cili sjell eksperiencën e tij në kuadër të shkëmbimit akademik. Diskutimet, aktivitetet shkencore dhe leksionet e hapura kanë si qëllim kryesor përmirësimin e aftësisë së mësimdhënies. Rezultatet pasqyrohen formalisht në raportet e NJSBC ku identifikohen edhe problemet që mund të hasen në procesin e mësimdhënies. <i>[Ev. Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik; Pyetësi i stafit akademik të KPL; Pyetësi i studenteve; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtuesin e DTI dhe stafin akademik]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Azhornimi me metodat e reja në mësimdhënie, konsiderohet si një objektiv parësor i personelit akademik edhe në zbatim të kontratave të punësimit që ata kanë. Në fillim të vitit akademik bëhen të ditura programet e lëndëve të cilat pasi firmosen, zbatohen me rigorozitet nga personeli. Nisur nga specifika e programit të studimit, kombinimi i pjesës teorike me atë praktike zë një vend të rëndësishëm në metodologjinë mësimdhënies duke shfrytëzuar metodat moderne të TI. Strukturat e monitorimit raportojnë mbi rezultatet duke analizuar edhe mbi përmbushjen e pritshmërive. <i>[Ev. Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies; Vizita e GVJ dhe takimi me stafin akademik]</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Standardi III.4				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen nga disa rregullore si e KUQ dhe rregulloret që rrjedhin nga ajo përkatesisht të KPL dhe DTI. Elementët e vlerësimit pasqyrohen në syllabusin e lëndës dhe përbëhen kryesisht nga vlerësimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, aktivizimi gjatë seminareve apo testeve. Dokumentacioni ruhet për një periudhë 6 mujore në rast të nevojës për rishikim apo rivlerësim të tij. [Ev. Rregullore e KUQ dhe KPL; Rregullore e DTI; Syllabuset e lendeve; Vizita e GVJ ne sekretarine mesimore]			
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke ju referuar rregulloreve përkatëse të KUQ, KPL dhe DTI si edhe syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton forma të kontrollit të njohurive si kontrolli i vazhdueshëm, i ndërmjetëm dhe përfundimtar. Janë përcaktuar po ashtu në mënyrë të detajuar tabelare edhe elementët vlerësues me pikët përkatëse. Secili prej elementëve vlerësues lidhet me format e kontrollit të njohurive të konstatuara më lart. Vlerësimi i studentit bëhet me notë e cila pasqyron shumën e vlerësimeve të elementëve të veçantë. Korrespondenca midis pikëve të grumbulluara nga studenti dhe notës është përcaktuar në një tabelë përmbledhëse. Format dhe mënyrat e kontrollit të njohurive janë të tilla që lejojnë studentët të angazhohen si në aspektin teorik dhe atë praktik duke u dhënë mundësinë të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Ev. Rregullore e KUQ dhe KPL; Rregullore e DTI; Syllabuset e lendeve; Vizita e GVJ ne takim me studentet e programit te studimit TI]			
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Përpara fillimit të lëndës, studentëve ju bëhen të dituara nga ana e pedagogut elementet e syllabusit duke përfshirë format e kontrollit të njohurive, elementët përbërës, pesha në pikë e secilit prej tyre si edhe mënyra e përlllogaritjes së notës përfundimtare. Titullari i lëndës kujdeset për të informuar studentët edhe mbi vlerësimin e marrë për secilin prej elementëve vlerësues në funksion të transparencës dhe zbatimit me korrektësi të rregullores së DTI. Gjate vizites në KUQ, në takimin me studentët u bë po ashtu një përshkrim i shkurtër i procedurës së informimit. [Ev. Rregullore e DTI; Syllabuset e lendeve; Vizita e GVJ ne takim me studentet e programit te studimit TI]			

<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatit, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive bëhet sipas formave të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe në mënyrë më specifike në syllabusin e lëndës. Ky kontroll synon të vleresojë studentin në mënyrë të vazhdueshme duke e motivuar atë të jetë aktiv në mësimnxënie gjatë gjithë semestrit. Provimet sekretohen nga ana e sekretarisë mësimore në funksion të ruajtjes së anonimatit në vlerësim (nuk përdoret ndonjë sistem elektronik për vlerësim). Rezultatet ju komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve por edhe nga ana e sekretarisë mësimore. Në rast të pretendimeve mbi vlerësimin, organizohen takime me pedagogun ku sqarohen pikët e vlerësimit. Studenti ka edhe të drejten e ankimit në rast se nuk është i bindur mbi vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut. [Ev. Rregullore e KUQ dhe KPL; Rregullore e DTI; Syllabuset e lendeve; Vizita e GVJ ne takim me studentet e programit te studimit TI]</p>			
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e DTI mbi zhvillimin e provimeve, marrja e studentëve në provim realizohet nga një komision provimi me jo më pak sesa dy pedagogë nën drejtimin e titullarit të modulit apo lëndës. Ky komision miratohet nga Drejtori i KPL dhe menaxhon mbarëvajtjen e provimit duke respektuar rregulloren përkatëse në lidhje me lejimin e studentëve në provim apo edhe lejimin e personave të autorizuar dhe drejtuesve të njësisë bazë. Gjatë njoftimit të rezultatit të provimit, komisioni i bën të ditur studentit edhe komentet mbi vlerësimin duke u fokusuar edhe tek ato pjesë ku studentit ka marrë me pak pikë dhe ka nevojë të përmirësohet. [Ev. Rregullore e KPL; Rregullore e DTI; Syllabuset e lendeve; Vizita e GVJ ne takim me stafin akademik]</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në bazë të Rregullores se DTI “Mbi rezultatet e provimeve dhe shpallja e tyre”, komisioni i provimit respekton një periudhë nga 1 deri në 5 ditë kur provimi është me gojë apo me shkrim. Rezultatet bazohen në një vlerësim rigoroz të të gjithë elementëve të përcaktuar në format e kontrollit për të pasur një vlerësim sa më real të merituar nga ana e studentit. Mbas afishimit të rezultatit, studentit i lind e drejta për të marrë sqarim nga komisioni i provimit brenda 24 orëve. Në rast të kundert nota quhet e pranuar dhe përfundimtare. Rregullorja përcakton po ashtu rastet e hedhjes së gabuar të notave apo edhe rastet e jashtëzakonshme të cilat mund të korrigjohen sipas procedurës përkatëse. [Ev. Rregullore e DTI; Vizita e GVJ ne takim me studentet e programit te studimit TI]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi i studimit profesional 2 vjeçar “Teknologji Informacioni” është zhvilluar mbi bazën e dokumentit “Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit profesional i ciklit 2-vjeçar Teknologji Informacioni” në të cilin janë përshkruar midis të tjerash edhe misioni dhe qëllimi i programit. Fokusi kryesor është në përgatitjen e studentëve dhe teknikëve cilësorë në përputhje me kërkesat e kohës. Njohuritë teorike dhe praktike të marra në këtë program studimi, do t’ju shërbejnë të diplomuarve që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në përputhje edhe me politikat e zhvillimit kombëtar. Programi është përshtatur duke përdorur edhe modele të ngjajshme për ti shërbyer sa më mirë qëllimit të zhvillimit të tij.</p> <p>[Ev. Rregullore e DTI; Plani strategjik i zhvillimit të programit TI; Vizita e GVJ ne takim me drejtorin e KPL dhe Pergjegjesin e DTI]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Duke ju referuar lëndëve të përfshira në programin e studimit, vihet re një kombinim i lëndëve të formimit të përgjithshëm si Matematikë, Fizikë, gjuhët e huaja etj. dhe atyre me formim profesional të cilat janë specifike për fushën e TI. Lëndët e formimit të përgjithshëm janë përfshirë në semestrin e parë dhe të dytë krahas atyre të formimit profesional të cilat shtrihen në semestrat 3 dhe 4 për çdo drejtim TIK, Elektronikë dhe Web Design. Në semestrin e 4 lëndët janë specifike duke u thelluar në drejtimin përkatës. Përfshirja e gjuhëve të huaja si Anglisht dhe Gjermanisht, është një mundësi e mirë për të lehtësuar punën me terminologjinë e huaj që ndeshet shpesh në fushën e TI. Zhvillimi i praktikës profesionale konsiderohet po ashtu një mundësi e mirë kur studentët rrisin aftësitë komunikuese në ambjentin ku ata zhvillojnë praktikën si edhe njihen me problematika të ndryshme. Shkëmbimi i experiencës gjatë praktikës ndihmon në përshtatjen me ambjentin e punës dhe rrit aftësinë për zgjidhjen e problemeve që mund të hasen mbas daljes në tregun e punës.</p> <p>[Ev. Programi mesimor i programit të studimit të ciklit 2-vjeçar TI; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtorin e KPL, pergjegjesin e DTI, stafin akademik dhe studentet]</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur</p>	<p>Ndërthurja e mësimiit teorik me punët e laboratorit është një mundësi e mirë për të zhvilluar aftësitë praktike të cilat do t’ju shërbejnë studentëve që të përmbushin sa më mirë pritshmeritë e kompanive apo institucioneve ku zhvillohet praktika profesionale. Dy laboratorët në dispozicion të DTI kanë bazën e nevojshme materiale që mësimdhënësit të orientojnë studentët në ato punë praktike të cilat i afrohen më shumë detyrave të praktikës në terren</p>

<p>format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>duke i aftësuar ata për të qenë më të motivuar në përbushjen e detyrimeve në kompanitë e biznesit. Gjatë vizitës në KUQ, një pjesë e studentëve e vunë theksin tek rëndësia që ka praktika profesionale dhe përfitimet konkrete nga realizimi me sukses i saj. [Ev. <i>Infrastruktura mesimore e KUQ; Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit TI; Vizita e GVJ ne ambjentet e KUQ dhe takimi me stafin akademik</i>]</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde, supozohet që studenti të ketë marrë njohuri të nevojshme dhe aftësi praktike të cilat kontrollohen me ane të formave të përcaktuara në syllabusin e lëndës. Mbas vlerësimit me notë të studentit, personeli akademik bën një analizë në lidhje me përbushjen e pritshmërive si edhe mangesitë apo problemet e vërejtura. Si rezultat i analizës, personeli akademik merr vendime mbi çështje që kanë nevojë për diskutim apo përmirësim duke propozuar edhe zgjidhjet përkatëse të cilat do të duhet të implementohen në vazhdim. Raporti i analizës së punës vjetore dokumenton problematikat dhe zgjidhjet përkatëse në funksion të përmirësimit të një formimi cilësor. [Ev. <i>Analiza vjetore e DTI; Vizita e GVJ dhe takimi me drejtuesin e DTI dhe stafin akademik</i>]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Procedurat e diplomimit janë të përshkruara në Rregulloren e DTI. Studentit i jepet mundësia të zgjedhë formën e diplomimit në varësi të rezultateve në përfundim të dy viteve të studimit. Për studentët me notë mesatare nën 9, mundësia e diplomimit është vetëm me anë të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Procedurat e diplomimit janë publike dhe studentët informohen mbi to si edhe mbi afatet që duhet të respektojnë. Për temat e diplomave studenti merr vetë shpenzimet e realizimit të temës dhe në përfundim të saj bëhet mbrojtja para një komisioni vlerësimi me 5 anetarë të propozuar nga DTI. Rregullorja merr parasysh edhe raste kur studenti nuk mund të diplomohet dot në katër sezone duke e pajisur studentin me një dëshmi si “Teknik i lartë i padiplomuar”. Të gjitha diplomatat regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në MAS. [Ev. <i>Rregullore e DTI; Rregullore e diplomimit; Diplomat dhe suplementi; Vizita e GVJ ne sekretarine mesimore</i>]</p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>DTI ka përgjegjësinë e krijimit të kushteve për diplomim të studentit duke përcaktuar listën e temave si edhe udhëheqësve. Temat mund të realizohen dhe në bashkërendim me personelin akademik duke shfrytëzuar edhe marrëveshjet me institucionet e tjera ku studenti ka mundësi të kryejë punën eksperimentale nëse është e nevojshme. Duke qenë një diplomë profesionale, ndërthurja e pjesës teorike me elementë praktikë është një kriter i rëndësishëm. Megjithatë, fakti që shpenzimet e temës duhet të mbulohen tërësisht nga studenti mund të ketë një ndikim disi negativ në motivimin e studentëve shumë të mirë për të përgatitur temë diplome. [Ev. <i>Rregullore e DTI; Rregullore e diplomimit; Diplomat dhe suplementi; Vizita e GVJ ne takim me pergjegjesin e DTI</i>]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Referuar Statutit të KUQ, (neni 30), kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë hartohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision adhoc, i përbërë në shumicë nga njësia bazë përkatëse. Komisioni adhoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon Rektorit dhe ky i fundit jep mendimin e tij për emërimin me kohë të plotë të punonjësit. Vendimin për emërimin e lëshon asambleja e shoqërisë themeluese e KUQ [Ev. Statuti i KUQ, neni 30]. GVJ, gjatë takimeve në zyrën e Burimeve Njerëzore, u njoh me praktikën e rekrutimit të PAE dhe PAK dhe e gjeti këtë praktikë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me Statutin e KUQ. Renditja e kandidatëve bëhet në bazë të një sistemi pikëzimi. Preferohen kandidatët që zotërojnë një gradë/titull të fituar në universitete jashtë vendit. [Ev. Minutat e vizitës].</p> <p>Përa i përket kohëzgjatjes së kontratave, GVJ konstatoi se gjithë personeli akademik efektiv është i angazhuar me kontrata 1 vjeçare, të rinovueshme [Ev. Minutat e vizitës]. GVJ është i mendimit se një aplikim i tillë në shkallë të gjerë, i kontratave të përkohshme, potencialisht krijon rrezikun e paqëndrueshmërisë së personelit akademik në vite.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet</p>	<p>Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstatoi se për statin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i plotë. Dosjet e konsultuara në mënyrë rastësore nga GVJ u gjetën të plota. Në këtë dokumentacion përfshihen CV e përditësuar, kualifikime, punimet me të fundit kërkimore shkencore, kontrata e punës etj. [Ev. Takimet në ZBNj; Minutat e vizitës]. Për personelin akademik me kontratë, në dosje, disponohet edhe leja e institucionit ku ky personel është i angazhuar me kohë të plotë. Gjithashtu, angazhimi i personelit akademik efektiv dhe me kontratë në procesin mësimor është i dokumentuar edhe në DTI, ku mbahet</p>

partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.	evidenca për lëndët e zhvilluara si ngarkesën mësimore për secilin pedagog [Ev. Analizë vjetore e Departamentit TI].																														
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se DTI, i cili është përgjegjës për këtë program, ka angazhuar burimet njerëzore në dispozicion, të cilat disponojnë kualifikimin e duhur, për të realizuar me cilësinë e duhur, në funksion të objektivave, formimin në këtë program studimi. Për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021 ngarkesa mësimore për programin e studimit me karakter profesional "<i>Teknologji informacioni</i>", është realizuar nga personeli akademik si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="651 555 1369 824"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th colspan="3">PAE (kategoria)</th> <th colspan="3">PAK (kategoria)</th> </tr> <tr> <th>Profesor (Prof./Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>As.Lektor (MSc)</th> <th>Profesor (Prof./Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>As.Lektor (MSc)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Ev. RVB; Lista e stafit akademik; Takime në institucion], [Ev.shtesë: Ngarkesa mesimore 2019-2020; Ngarkesa mesimore 2020-2021]. Për arsye të numrit relativisht të vogël të studentëve, DTI nuk ka angazhuar personel ndihmës akademik në funksion të këtij programi studimi.</p>				Viti	PAE (kategoria)			PAK (kategoria)			Profesor (Prof./Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)	Profesor (Prof./Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)	2019-2020	1	2	3	1	1	2	2020-2021	1	2	3	3	1	1
Viti	PAE (kategoria)			PAK (kategoria)																											
	Profesor (Prof./Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)	Profesor (Prof./Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)																									
2019-2020	1	2	3	1	1	2																									
2020-2021	1	2	3	3	1	1																									
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimet me autoritetet drejtuese si dhe më pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se KUQ angazhohet për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik. Këtij qëllimi i shërben edhe fondi KUQ prej rreth 24 mijë eurosh, i dedikuar kërkimit shkencor. Institucioni ka mbështetur zhvillimin e konferencave në të cilat ka marra pjesë personeli akademik i DTI [Ev. Minutat e vizitës; RVB; Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ].</p> <p>Gjithashtu, për nga vetë natyra e programit të studimit me karakter profesional "<i>Teknologji informacioni</i>", ka gjetur vend përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimi i teknologjive të reja. Zhvillimi i përdorimit të teknologjive të reja është kushtëzuar në një masë të konsiderueshme dhe nga zhvillimi i procesit mësimor në kushtet e pandemisë [Ev. Takimet në institucion; RVB; Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies].</p>																														
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>																											
			X																												

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se KUQ disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Kjo dhe për arësyje të numrit relativisht të vogël të studentëve. Gjithashtu, baza laboratorike informatike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi [Ev. Vizita në institucion; Takimet me studentët; Takimet me pedagogët e DTI].
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	KPL ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise të mjaftueshme, me kushte të përshtatshme dhe të paisura me infrastrukturën e duhur për shvillimin normal të procesit mësimor. Nga analiza e RVB, konstatohet se, në situatën aktuale, KUQ garanton mjedise që i korrespondojnë rreth 7.8 m ² /student dhe rreth 9.6m ² /personel akademik. Veç kësaj, disponohen edhe mjedise të përshtatshme çlodhjeje si dhe për zhvillimin e aktiviteteve të studentëve. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi [Ev. RVB; Infrastruktura mësimore e KUQ; Vizita në institucion]. Gjithashtu, për nga vetë natyra e programit të studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni ", mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si mundësi aksesimi të rrjetit Wireless dhe kabllor, përdorimi i smartboard etj. [Ev. Vizita në institucion].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në funksion të zhvillimit të procesit mësimor për programin e studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni ", KPL ka vënë në dispozicion 2 laboratorë: Laboratori e informatikës me 23 poste, me rrjet LAN dhe Wireless, lidhje internet dhe të kompletuar jo vetëm me programet informatike (software) standarte, por edhe me programe në funksion të moduleve dhe Laboratori i elektronikës i kompletuar me pajisjet e nevojshme për zhvillimin e punëve praktike e laboratorike. Gjatë qëndrimit në institucion, GVJ vizitoi këta laboratorë dhe i gjen ata të përshtatshëm dhe me kapacitetin e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor [Ev. RVB; Vizita në institucion].
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me	Referuar dokumentacionit të DVV, konfirmuar dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se KUQ ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit [Ev. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit TI dhe praktikën profesionale]. Në mënyrë të veçantë, ka marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale të programit të studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni ". GVJ u njoh me raportin e hartuar nga DTI " Mbi përfitimet nga marrëveshjet e

karakter profesional.	<i>bashkëpunimit për programin e studimit profesional te ciklit 2-vjeçar "Teknologji Informacioni" ku paraqiten përfitimet nga aktmarrëveshjet e bashkëpunimit si dhe janë paraqitur edhe detyra për të ardhmen në drejtim të një analize periodike të përfitimeve nga bashkëpunimi e në mënyrë të veçantë zgjerimin e bashkëpunimit në shërbim të praktikave të studentëve dhe punësimit të ardhshëm të tyre. [Ev. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit TI].</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	KUQ, në ambientet e tij, vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën mësimore e cila disponon një fond prej 1358 librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. GVJ, gjatë vizitës në bibliotekë konstatoi se ka dhe një numër titujsh të cilët mbështesin formimin në programin e studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> ". Biblioteka qëndron e hapur në intervalin 8:00 – 16:00 duke mundësuar shfrytëzimin normal nga ana e studentëve [Ev. RVB; Vizita në institucion].			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në analizë vjetore të DTI analizohet edhe nevoja e fuqizimit të bibliotekës dhe vlerësohet dhënia e fondeve nga Bordi i Administrimit për paisjen e bibliotekës me literaturë bazë e ndihmëse për çdo lëndë e modul, sidomos për Teknologjinë e Informacionit që kishte mangësi duke arritur që biblioteka të pajiset me literaturë bazë për çdo program studimi në masën mbi 95%. Për programin e studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " ka në dispozicion rreth 30 tituj [Ev. Analizë vjetore e Departamentit TI; Lista e teksteve në bibliotekë në funksion të programit TI]			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Megjithatë, mund të thuhet se literatura është pak e varfër, por po punohet për implementimin e bibliotekave on-line (EBSCO Library). [Ev. Vizita në institucion]. Për të mundësuar pasurimin e bibliotekës, janë shfrytëzuar edhe marrëveshjet e bashkëpunimit, siç është rasti i bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nga e cila është siguruar edhe mbështetje me literaturë tekniko-shkencore për bibliotekën tituj [Ev. Analizë vjetore e Departamentit TI].			
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t' u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në	Referuar RVB, DVV dhe takimeve në institucion, rezulton se marrëveshjet e bashkëpunimit me aktorë të jashtëm kanë rezultuar të frytshme duke u mundësuar studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së tyre gjatë kryerjes së praktikave profesionale. Gjithashtu janë zhvilluar edhe kurse kompjuteri falas për programe profesionale të dizenjimit me studentët e programit (duke vënë në dispozicion infrastrukturën kompjuterike me softwarë përkatës). Është			

varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	për t'u theksuar qasja pozitive e DTI, i cili merr në analizë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit [Ev. RVB; Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit TI; Takime në institucion].			
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	KUQ ka realizuar një analizë të hollësishme financiare të programit të studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni ". Nga kjo analizë rezultoi se kostoja e programit mbulohet plotësisht nga të ardhurat siguruar nga tarifa për studentët duke siguruar teorikisht edhe një fitim të konsiderueshëm. Megjithatë, GVJ vëren se kjo analizë bazohet në një numër total prej 140 studentësh (50 në vitin e parë dhe 90 në vitin e dytë). Faktikisht për vitin akademik 2019-2020 numri i studentëve ka qenë 56 (28 në vitin e parë dhe 28 në vitin e dytë), ndërsa në vitin akademik 2020-2021 numri i studentëve ka qenë 43 (22 në vitin e parë dhe 21 në vitin e dytë). Situata paraqitet më delikate për vitin akademik 2021-2022 ku numri total i studentëve ka rënë në 24 (21 në vitin e parë dhe 3 në vitin e dytë), nga të cilët në vitin e parë janë regjistruar 6 studentë të rinj. Në këto kushte, GVJ është i mendimit se pa një përmirësim të situatës së pranimeve të reja të studentëve, programi i studimit rrezikon vazhdimësinë e tij. [Ev. shtesë: Tabele permbledhese e studentëve] [Ev. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit TI]			
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e KUQ, (i përditësuar më 23.12.2020), Rregulloren e KUQ, Rregulloren e DTI, Rregulloren e programit të Studimit TI, Rregulloren e praktikës profesionale dhe Rregulloren e diplomimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KUQ zhvillohet në përputhje me këto rregullore dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet. [Ev. Statuti i KUQ; Rregullorja e KUQ, Rregullorja e DTI, Rregullorja e programit të Studimit TI, Rregullorja e praktikës profesionale; Rregullorja e diplomimit]
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter	Pranimi i studentëve në programin e studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni " bazohet në legjislacionin në fuqi. Senati i KUQ miraton kriteret e pranimit për gjithë institucionin ku përfshihen edhe kriteret e pranimit për këtë program me specifikat e tyre. Në renditjen përfundimtare të kandidatëve për studentë merren në

<p>profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm; - Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës shtetërore; - Kriteri i rëndësisë së shkollës nga vjen kandidati. <p>duke ju referuar një formule që merr në konsideratë edhe koeficientin e shkollës së mesme dhe koeficientin e profilit [Ev. <i>Kriteret e pranimit studentëve në KPL</i>].</p> <p>GVJ u informua se kriteret e hartuara publikohen në faqen zyrtare të internetit të KUQ dhe se organizohen edhe vizita në institucion për të njohur kandidatët për studentë me ambientet, pedagogët dhe programet e studimit [Ev. <i>Takime në institucion</i>].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se informacioni i plotë në lidhje me me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit janë të pasqyruara qartë në Rregulloret e KUQ. Në mënyrë të veçantë Rregullorja e programit të Studimit TI jep elementë më të hollësishëm në lidhje me këtë program. [Ev. <i>Rregulloret e KUQ; Takime në institucion</i>].</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Elementë më të detajuar për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës u transmetohen studentëve në takimin ceremonial të organizuar nga Rektorati i KUQ me fillimin e procesit mësimor si dhe nga personeli akademik në javën e parë të procesit mësimor ku bëhet njohja e studentëve edhe me syllabusin e lëndës, mënyrën e shlyrjes së detyrimeve, mënyrën e vlerësimit etj. Nga takimi i organizuar me studentët e programit të studimit me karakter profesional "<i>Teknologji informacioni</i>", GVJ konstatoi se ata janë të informuar për gjithë këta elementë përfshirë dhe mundësitë e kryerjes së praktikave profesionale dhe punësimit të ardhshëm të tyre [Ev. <i>RVB, Takime në institucion</i>].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>KUQ komunikon me studentët e më gjerë me publikun nëpërmjet website https://www.qiriaz.edu.al/ ku pasqyrohen informacionet bazë për institucionin. Megjithatë GVJ është i mendimit se informacioni i pasqyruar në website të KUQ është i relativisht i përgjithshëm dhe se përditësimi i le për të dëshiruar.</p> <p>Burim informacioni të vlefshëm, sidomos në fazën e tërheqjes së kandidatëve për studentë, përbën dhe fletë-palosja e përgatitur nga KUQ [Ev. <i>Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriaz"</i>].</p> <p>Informacion për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion më i gjerë e i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij u jepet studentëve nga ana e pedagogëve të lëndëve dhe e tutorit të programit [Ev. <i>Takime në institucion</i>].</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Pavarësisht se në RVB dhe në DVV flitet për sistemin e menaxhimit të informacionit të KUQ, GVJ nuk konstatoi një sistem informacioni të informatizuar i cili të jetë efektiv e funksional, por një synim për t'u arritur në të ardhën [Ev. <i>Vizita në institucion</i>]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Menaxhimi i informacionit në KUQ garantohet nga Rregulloret përkatëse [Ev. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit]. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Informacioni mbahet në format letër, ndërsa si format elektronik shërbejnë tabelat në Excel. Sekretaria mësimore menaxhon rezultatet e provimeve, por jo informacionin e detajuar lidhur me frekuentimin (i cili menaxhohet nga pedagogët përkatës të lëndëve dhe depozitohet në departament). Gjithashtu Sekretaria mësimore menaxhon edhe informacionin në lidhje me proces-verbalet e provimeve për sezonet e ndryshme gjatë vitit akademik. [Ev. Vizita në Sekretarinë mësimore].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit menaxhohet sipas njësive dhe zyrave përkatëse në përputhje me specifikat e këtij dokumentacioni. Në këtë mënyrë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe arkivit menaxhon informacionin në lidhje me personelin akademik efektiv dhe me kontratë, personelin administrativ si dhe aktmarrëveshjet me IAL dhe institucione shtetërore e shoqëri private që kontribuojnë në realizimin e programit të studimit, ndërsa Sekretaria mësimore menaxhon informacionin që lidhet me studentët [Ev. RVB, Takime në institucion]. Megjithatë, GVJ është i mendimit se KUQ nuk disponon një sistem të integruar informacioni i cili do të garantonte akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit [Ev. Vizita në institucion].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ nuk gjeti në KUQ një sistem menaxhimi aktiv i cili të kishte të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Komunikimi realizohet nëpërmjet postës elektronike të personalizuar të institucionit (...@qiriazi.edu.al). Gjithashtu GVJ u informua për përdorimin në shkallë të gjerë gjatë periudhës së pandemisë të platformave të komunikimit online si Google Classroom, Google Meet, Zoom, e Google Hangouts në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor në distancë [Ev. RVB; Takime në institucion; Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ nuk gjeti në KUQ një sistem menaxhimi aktiv i cili të kishte të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Komunikimi realizohet nëpërmjet postës elektronike të personalizuar të institucionit (...@qiriazi.edu.al). Gjithashtu GVJ u informua për përdorimin në shkallë të gjerë gjatë periudhës së pandemisë të platformave të komunikimit online si Google Classroom, Google Meet, Zoom, e Google Hangouts në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor në distancë [Ev. RVB; Takime në institucion; Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line].

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit i KUQ mundëson përfitim të informacionit të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna për organet drejtuese dhe titullarët, por nga sa u konstatua nga GVJ gjatë vizitës në institucion, nuk garantohej monitorimi në kohë reale i këtyre aktiviteteve. Sistemi i informacionit i cili synohet të shërbejë për këtë qëllim është konceptuar si projekt dhe bën pjesë në objektivat e KUQ [Ev. Vizita në institucion]			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KUQ zotëron një faqe interneti (https://www.qiriaz.edu.al/) e cila është e organizuar vetëm në gjuhën shqipe. Në të botohet një informacion i strukturuar në lidhje me programet e studimit, stafin akademik, organet dhe autoritetet drejtuese, bashkëpunimet, kërkimin shkencor si dhe dhe aktivitetet e tjera të KUQ. Gjithashtu, KUQ është i pranishëm, duke pasqyruar një informacion të konsiderueshëm, në rrjetet sociale si <i>Facebook, Instagram dhe Youtube.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	KUQ ka hartuar dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve. Këto politika dhe procedura bazohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë mbështeten në Statutin e KUQ, (i përditësuar më 23.12.2020), Rregulloren e KUQ, Rregulloren e DTI, Rregulloren e programit të Studimit TI, Rregulloren e praktikës profesionale dhe Rregulloren e diplomimit. Nga takimet në institucion, përfshirë takimin me studentët, GVJ konstatoi se veprimtaria e KUQ zhvillohet në përputhje me këto rregullore dhe se u garantohej barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet. Gjithashtu, marrëveshjet me komunitetin e biznesit dhe shoqëritë private i kanë shërbyer edhe orientimit të studentëve drejt tregut të punës duke garantuar në praktikë barazinë dhe të drejta të njëjta. [Ev.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të	

drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<i>Statuti i KUQ; Rregullorja e KUQ, Rregullorja e DTI, Rregullorja e programit të Studimit TI, Rregullorja e praktikës profesionale; Rregullorja e diplomimit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Senati i KUQ miraton kriteret e pranimit për gjithë institucionin ku përfshihen edhe kriteret e pranimit për programin e studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " me specifikat përkatëse. Në renditjen përfundimtare të kandidatëve për studentë merren në konsideratë: <ul style="list-style-type: none"> - Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm; - Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës shtetërore; - Kriteri i rëndësisë së shkollës nga vjen kandidati. duke ju referuar një formule që merr në konsideratë edhe koeficientin e shkollës së mesme dhe koeficientin e profilit [Ev. <i>Kriteret e pranimit studentëve në KPL</i>]. GVJ u informua se kriteret e hartuara publikohen në faqen zyrtare të internetit të KUQ dhe se organizohen edhe vizita në institucion për të njohur kandidatët për studentë me ambientet, pedagogët dhe programet e studimit [Ev. <i>Takime në institucion</i>].
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se informacioni i plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, janë të pasqyruara qartë në Rregulloret e KUQ dhe janë të vlefshme dhe për këtë program studimi. GVJ vlerëson se ky informacion është i plotë dhe se studentët janë të njohur me të. [Ev. <i>Rregulloret e KUQ; Takime në institucion</i>].
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit në programin e studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> " janë përcaktuar në Rregulloret e KUQ dhe specifikisht në Rregulloren e programit të Studimit TI. Elementë shtesë në lidhje me detyrimet e studentëve dhe mënyrën e shlyerjes së tyre jepen në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi se studentët janë të informuar për këto procedura në mënyrë të detajuar gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve. Diplomimi organizohet në masën dërmuese nëpërmjet provimit të formimit. Diplomimi nëpërmjet punimit të diplomës është i mundur vetëm për studentët të cilët arrijnë një notë mesatare të periudhës së studimeve jo më të ulët se 9. Duke qenë se ky kufi i notës mesatare është shumë i lartë, deri më tani nuk ka patur ndonjë student të diplomuar nëpërmjet punimit të diplomës [Ev. <i>Rregulloret e KUQ; Takim me studentët</i>].
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në takimin ceremonial të organizuar nga Rektorati i KUQ me fillimin e procesit mësimor u transmetohen studentëve elementë më të detajuar për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Krahas përditësimit të faqes web me informacione që lidhen me pranimet në këtë program studimi (përpara fillimit të vitit akademik), burim informacioni të vlefshëm në këtë fazë përbën dhe fletë-palosja e përgatitur nga KUQ si dhe vizitat e maturanëve në institucion [Ev. <i>RVB; Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazit"</i>]. Nga takimi i organizuar me studentët e programit të studimit me karakter

	profesional " <i>Teknologji informacioni</i> ", GVJ konstatoi se ata janë të informuar për gjithë këta elementë [Ev. Takim me studentët].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Studentët e KUQ njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të që në takimin ceremonial të organizuar nga Rektorati i KUQ me fillimin e procesit mësimor. Në mënyrë më të detajuar njihja me këta elementë realizohet nga ana e personeli akademik në javën e parë të procesit mësimor ku bëhet njihja e studentëve edhe me syllabusin e lëndës, mënyrën e shlyrjes së detyrimeve, mënyrën e vlerësimit etj. Në mënyrë të veçantë, Rregullorja e KUQ, Rregullorja e DTI, Rregullorja e programit të Studimit TI, Rregullorja e praktikës profesionale dhe Rregullorja e diplomimit japin gjithë elementë e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve [Ev. Statuti i KUQ; Rregullorja e KUQ, Rregullorja e DTI, Rregullorja e programit të Studimit TI, Rregullorja e praktikës profesionale; Rregullorja e diplomimit]. Përsa i përket informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, këto janë të shtjelluara në planin mësimor të programit dhe në syllabuset e lëndëve. Nga takimi i organizuar me studentët e programit të studimit me karakter profesional " <i>Teknologji informacioni</i> ", GVJ konstatoi se ata janë të informuar në mënyrë të vazhdueshme për gjithë këta elementë [Ev. RVB, Takim me studentët].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikatat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Në planin mësimor të programit të studimit bën pjesë dhe praktika profesionale, me një vëllim prej 7 kreditesh ECTS, si një aktivitet me rëndësi për formimin në një program me karakter profesional. Zhvillimi i praktikës profesionale mbështetet nga një numër marrëveshjesh me komunitetin e biznesit dhe shoqëritë private. Këto marrëveshje kanë kontribuar edhe për krijimin e mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve si dhe punësimit të tyre mbas diplomimit. Gjatë takimit me studentët e programit GVJ konstatoi se studentët jo vetëm janë të informuar për këto marrëveshje, por kanë përfituar nga zhvillimi i praktikës në subjektet përkatëse si dhe nga mundësi të punësimit me kohë të pjesshme apo edhe të plotë [Ev. RVB, Takim me studentët].
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet	Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve

në funksion të realizimit të tij.	<p>përkatëse, mënyrën e shlyerjes së tyre dhe infrastrukturën laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre [Ev. Takime në institucion].</p> <p>Informacioni shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, tarifat, notat etj [Ev. Vizita në Sekretarinë mësimore].</p> <p>Burim tjetër informacioni përbën faqja web e KUQ (https://www.qiriaz.edu.al/), ku mund të gjendet një informacion bazë për elementë që lidhen me programin e studimit. Megjithatë, GVJ konstatoi se kjo faqe nuk përditësohet rregullisht. Rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Youtube përbëjnë një burim tjetër informacioni për aktivitetet e KUQ.</p>			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>GVJ konstatoi se, megjithëse nuk është aktiv një sistem i integruar i menaxhimit të brendshëm të informacionit, numri relativisht i ulët i studentëve në këtë program mundëson një informim përmes komunikimit aktiv pedagog – student. Studentët kanë adresë e-mail të institucionit dhe mund ta aksesojnë e përdorin nëpërmjet paisjeve individuale ose kompjuterave të laboratorit apo të bibliotekës [Ev. Takime në institucion].</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	<p>Një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave është sekretaria mësimore e KUQ e cila funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore.</p> <p>Sekretaria mësimore, ndërmjet të tjerave, është përgjegjëse për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtjen e regjistrit bazë të studentit me të dhënat personale, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën dhe suplementin e saj. Regjistri i studentit plotësohet me shkrim dhe mbahet edhe në formë elektronike (format Excel); 2. Mban dhe përditëson listën e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të larguar gjatë vitit akademik; 3. Sekretaria përpilon listat e studentëve në çdo kurs; 4. Sekretaria afishon data e provimeve, ndjek ecurinë e provimeve dhe menaxhon proces-verbalet për çdo provim së bashku me vlerësimet e bëra nga stafi akademik;

	<p>5. Sekretaria në bashkëpunim me hallkat drejtuese të DTI dhe KPL informojnë studentët për çdo çështje apo njoftim që prek drejtëpërdrejtë procesin mësimor dhe studentët;</p> <p>6. Sekretaria disponon dhe mban statistika vjetore rreth studentëve e të diplomuarve dhe i vë në dispozicion të autoriteteve drejtuese në KUQ.</p> <p>[Ev. Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takim në Sekretarinë mësimore]</p>														
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria mësimore. Të dhënat rruhen në rregjistra përkatës dhe në formë elektronike. Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportet vjetore që DTI përgatit [Ev. Analizë vjetore e DTI]. Për tre vitet e fundit:</p> <table border="1" data-bbox="635 712 1289 891"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Studentë të regjistruar</th> </tr> <tr> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019 - 2020</td> <td>27</td> <td>29</td> </tr> <tr> <td>2020 - 2021</td> <td>22</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>2021 - 2022</td> <td>21 (6 të rinj)</td> <td>3 (3 të rinj)</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Ev. Analizë vjetore e Departamentit TI (2019-2020), Ev.shtesë Tabelë përmbledhëse e studentëve].</p>	Viti akademik	Studentë të regjistruar		Viti I	Viti II	2019 - 2020	27	29	2020 - 2021	22	21	2021 - 2022	21 (6 të rinj)	3 (3 të rinj)
Viti akademik	Studentë të regjistruar														
	Viti I	Viti II													
2019 - 2020	27	29													
2020 - 2021	22	21													
2021 - 2022	21 (6 të rinj)	3 (3 të rinj)													
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në rregjistrat përkatës) dhe në format elektronik (tabela Excel). Gjithashtu, edhe DTI, nëpërmjet Sekretarisë mësimore, disponon një informacion të gjerë lidhur me ecurinë e studentëve të cilin e integron edhe në raporte dhe analiza të aktivitetit të tij [Ev. Takim në Sekretarinë mësimore; Analizë vjetore e DTI]. Përsa i përket të dhënave të punësimit, krahas DTI, një rol të rëndësishëm në menaxhimin e këtij informacioni luan dhe "Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë". Nga ana e kësaj zyre, para se të diplomohen, u kërkohet studentëve të plotësojnë një skedë punësimi. Në vijim (pas diplomimit) kontaktohen të diplomuarit duke i pyetur nëse ju duhet ndihmë për t'u punësuar dhe njëkohësisht për të ruajtur kontaktet me ta [Ev. Takimi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë].</p> <p>Duhet theksuar se megjithëse janë diplomuar studentët e parë, për ta nuk ka qenë e mundur të paisjen me diplomë duke qënë se programi i studimit nuk ka kaluar fazën e akreditimit.</p>														
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria mësimore dhe mund të konsiderohen të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Nuk disponohet një sistem i mirëfillt për menaxhimin e këtij informacioni në rrugë elektronike. Megjithatë gjithë të dhënat ruhen edhe në format numerik (tabela Excel), duke bërë të mundur nxjerrjen e shpejtë e cilësore të të dhënave statistikore [Ev. RVB; Vizita në institucion].</p>														
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin</p>	<p>Pranimet në programin e studimit, cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve si dhe elementë që lidhen me punësimin e tyre trajtohen në raporte</p>														

dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	analitike siç është Raporti vjetor mbi veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të DTI. Ky raport, ndërmjet të tjerave, trajton edhe elementë që lidhen me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit (kalueshmërinë, notën mesatare etj.) dhe i shërben përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies duke përcaktuar edhe detyra për të ardhmen [Ev. <i>Analizë vjetore e DTI</i>].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Neni 48 i Statutit të KUQ dhe Neni 88 i Rregullores së KPL përcaktojnë funksionimin në institucion të Këshillave të Studentëve si organizime të pavaruar të studentëve. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. [Ev. <i>Statuti i KUQ; Rregullorja e KPL</i>].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KUQ garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NjSBC, Këshillin e Etikës si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke çertifikuar elementët e pasqyruar në Raport, sidomos ata elementë që kishin të bënin me praktikën profesionale dhe punësimin e tyre [Ev. <i>RVB; Statuti i KUQ; Minutat e takimit në institucion</i>].
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Hartimi i programit të studimit me karakter profesional " Teknologji informacioni " në profilet " Teknologji informacioni dhe komunikim ", " Elektronikë " dhe " Web Design " është bërë në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë" dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" duke marrë në konsideratë që ngarkesa javore në auditor të mos kalojë 25 orë [Ev. <i>Plani mësimor i programit të studimit TI</i>]. GVJ konstatoi se elementë të njohjes së studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme janë marrë në konsideratë në rregulloret përkatëse [Ev. <i>Rregullore e Departamentit TI</i>].
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e	Mendimi i studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të KUQ. Gjithashtu,

<p>hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>nëpërmjet pyetsorëve të studentëve tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A janë të përshtatshme planet mësimore; - A janë të ngarkuara planet mësimore; - A janë të përshtatshme kurrikulat; - A ka pjesëmarrje të studentëve në vendimmarrje. <p>Megjithatë, GVJ nuk pati në dispozicion rezultate të pyetsorëve të realizuar me studentët e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni", analizën e tyre dhe reflektimin në lidhje me sugjerimet eventuale [Ev. Pyetsori i studentëve].</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloren e KUQ dhe rregulloren e Departamentit të TI. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. Ankesa i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit të TI dhe për dijeni Drejtorit të KPL, e cila bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit (për parregullsitë gjatë zhvillimit të provimit) dhe në momentin e marrjes së përgjigjes së vlerësimit (për kontestimet që lidhen me vlerësimin). Ankesa depozitohet te Përgjegjësi i Departamentit të TI dhe pedagogu është i detyruar të kthejë përgjigje, maksimumi brenda ditës së nesërme.</p> <p>Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në KUQ funksionon "Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë" e cila integron dhe funksionin e informimit dhe shërbimit të studentëve. Në rregulloren përcaktohen misioni i kësaj zyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> - T'i shërbejë nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, të dizajnuara për të lehtësuar të mësuarit dhe avancimin e mirëqenies me qëllim zhvillimin e profesionalizmit, identitetit dhe të qytetarisë. - Organizimi i prezantimit të përvitshëm dhe promovimit të programeve që ofrojnë Fakultetet pranë shkollave të mesme.
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	

<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi dhe përditësimi i një database me të dhëna lidhur me shkollat e mesme. - Organizimi i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambientet e Fakulteteve duke siguruar prezencën e Dekanit, Shefave të Departanteve dhe Maturantëve. - Në bashkëpunim me zyrat respektive, shqyrton dhe i jep zgjidhje kërkesave të aplikantëve/maturantëve dhe studentëve aktiv. - Informon studentët, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe jo vetëm, brënda por dhe jashtë Kolegjit. Informacioni duhet të jetë i përditësuar dhe i publikuar elektronikisht dhe fizikisht. - Përgjigjet për përpilimin, plotësimin dhe përditësimin e Skedës së Punësimit për Studentët. - Siguron në kohë informacion për studentët lidhur me mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore etj. Informacioni duhet të jetë i përditësuar dhe i publikuar elektronikisht dhe fizikisht. - Prodhon dokumenta të nevojshme për studentët për realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. - Organizon Panairin e Karrierës së Studentëve, duke siguruar pjesëmarrje të insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. - Organizon shërbim pritjeje për t'ju përgjigjur interesave të aplikantëve/maturantëve të interesuar dhe studentëve aktivë të Kolegjit Universitar "Qiriazi", rreth çështjeve të ndryshme, ose kur konsiderohet e nevojshme ta referojë çështjen tek zyrat respektive, me qëllim zgjidhjen e tyre. <p>[Ev. Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë; Raporti Mujor-Zyra e Karrieres]</p> <p>GVJ konstatoi se në funksion të shërbimit dhe informimit të studentëve, me qëllim ndjekjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor, qasjen në literaturë dhe çështje të tjera që lidhen me jetën studentore, në KUQ funksionon dhe sistemi i tutoratit [Ev. Takime me pedagogët]</p> <p>GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se nga ana e kësaj zyre, kontaktohen të diplomuarit duke i pyetur në se ju duhet ndihmë për t'u punësuar dhe njëkohësisht për të ruajtur kontaktet me ta. Zyra ka dhënë kontributin e saj edhe për punësimin sezonal të studentëve apo edhe punësimin e tyre (me kohë të plotë apo të pjesshme) [Ev. Takimi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë].</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni", në profilet "Teknologji informacioni dhe komunikim", "Elektronikë" dhe "Web Design" të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Qiriazi"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji informacioni" është hartuar, përditësuar, plotësuar dhe përshtatur në përputhje me nevojat që ka tregu i punës dhe ekonomia shqiptare si dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar "Qiriazi".
2. Personeli akademik është i përkushtuar dhe zotëron kualifikimin e kërkuar për zhvillimin me sukses të programit të studimit;
3. KUQ disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Baza laboratorike informatike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit me aktorë të jashtëm kanë rezultuar të frytshme duke u mundësuar studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve dhe logjistikës së tyre gjatë kryerjes së praktikave profesionale.
5. Funksionimi i një sistemi tutorati në shërbim të komunikimit me studentët, me qëllim ndjekjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor, qasjen në literaturë dhe çështje të tjera që lidhen me jetën studentore.
6. Përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimi i teknologjive të reja.

Pika të dobta

1. Personeli akademik efektiv mbulon vetëm rreth 62-65% të ngarkesës mësimore, (nga një minimum i rekomanduar prej 70%).
2. Personeli akademik efektiv është i angazhuar me kontrata 1 vjeçare, të rinovueshme. Një aplikim i tillë në shkallë të gjerë, i kontratave të përkohshme, potencialisht krijon rrezikun e paqëndrueshmërisë së personelit akademik në vite.
3. Informacioni i pasqyruar në website të KUQ është i relativisht i përgjithshëm dhe se përditësimi le shumë për të dëshiruar.
4. Mungesa e një sistemi të integruar informacioni i cili do të garantonte akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.
5. Numër studentësh në rënie dhe cilësi relativisht e ulët e studentëve të pranuar.



6. Nota mesatare e kërkuar mbi 9 e nevojshme për diplomim nëpërmjet përgatitjes dhe mbrojtjes së një teme diplome është relativisht e lartë.
7. Mungesa e teksteve të përshtatur për këtë program studimi. Tekstet e përdorura janë të nivelit universitar.

Rekomandime

1. Ndërtimi i një sistemi informacioni të integruar efektiv e funksional.
2. Lidhja e kontratave të punës me afat të pakufizuar sidomos për personelin akademik me tituj e grada.
3. Të punohet për rritjen e numrit dhe cilësisë së studentëve të pranuar.
4. Institucioni të synojë mbulimin e të paktën të 70% të ngarkesës mësimore me personel akademik efektiv.
5. Shtimi i numrit të studentëve që diplomohen me temë diplome nëpërmjet uljes së pragut të mesatares.
6. Përmirësimi i nivelit të informacioni të pasqyruar në website të KUQ dhe ofrimi në dy gjuhë.
7. Përmirësimi i cilësisë së teksteve në përputhje me nivelin e formimit që ofron ky program studimi profesional dy vjeçar.

Conclusions of the Evaluation of the professional study program "Information Technology", in the profiles "Information Technology and Communication", "Electronics" and "Web Design" for the Higher Education Institution, University College "Qiriazi"

Strengths and affirmations

1. The professional study program "Information Technology" is designed, updated, improved and adapted according to the needs of the Albanian labor market and economy, as well as in accordance with the objectives and mission of "Qiriazi" University College.
2. The academic staff is dedicated and has the required qualification for the successful completion of the study program.
3. KUQ has sufficient and appropriate learning facilities for the development of the teaching activity. The equipment of the computer laboratory, guarantees a qualitative realization of the learning process in accordance with the specific nature of the modules that compose this study program.

4. Cooperation agreements with external partners have proven successful in allowing students to support and use their resources and logistics while carrying out the professional internships.
5. The establishment of a tutoring system for communication with students, in order to monitor issues related to the learning process, access to literature and other issues related to student life.
6. The use of innovative teaching methods and new technologies.

Weaknesses

1. The full-time academic staff covers about 62 to 65% of the teaching load, (from a recommended minimum of 70%).
2. The full-time academic staff is employed on the basis of one-year renewable contracts. Such a large-scale application of temporary contracts, potentially creates the risk of instability of academic staff over the years.
3. The information presented on the KUQ website is relatively general and its updating let much to be desired.
4. Lack of an integrated information system that would guarantee dedicated access to information and documents for all study program staff and students.
5. Decreasing number of students and relatively low quality of students admitted.
6. The grade point average, above 9, required for graduation through the preparation and defense of a diploma is relatively high.
7. Lack of suitable textbooks for this curriculum. The textbooks used are of university level.

Recommendations

1. Building an efficient and functional integrated information system.
2. Employment contracts agreement of indefinite term, in particular for the academic staff holding academic titles or doctoral degrees.
3. Make efforts to increase the number and quality of admitted students.
4. The institution should aim to cover at least 70% of the teaching load by the full-time academic staff.
5. Increase the number of students graduating with a diploma thesis by lowering the required grade point average.
6. Improve the level of information presented on the KUQ website and provide it in two languages.
7. Improve the quality of textbooks according to the level of training offered by this two-year professional study program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

